



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

Tiranë, më /05/2016

NJOFTIM PARAPRAK PËR PËRJASHTIM NGA NDALIMI I MARRËVESHJES

“NDËRMJET DIGITALB - OPERATOR TELEVIZIV”

Në datë 04.04.2016, Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 5 dhe nenin 49, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” ka marrë njoftimin nga DIGITALB, për përjashtimin e Marrëveshjes “**DIGITALB - OPERATOR TELEVIZIV**” me objekt mbartja e kanaleve TV në platformën numerike Digitalb.

DIGITALB SH.A ka si veprimtari kryesore: Ndërtimi dhe tregtimi i sistemeve të telekomunikacionit dhe transmetimeve televizive; Tregtimi i aparaturave për sistemet e transmetimit dhe marrjes së valëve televizive; Prodhimi transmetimi dhe shitja në mënyrë digitale e produkteve dhe shërbimeve audio e video. me adrese Rruga “Pavarsia” nr. 39 Kashar, tiranë,

Objekt i marrëveshjes është: përfshirja ekskluzive në platformën satelitore “DigitAlb” të kanalit televiziv “Kanal TIP”; mbartja e kanaleve TV **në platformën numerike Digitalb** të TOP CHANNEL, TOP NEWS, ABC NEWS, KLAN TV, ORA NEWS, NEWS-24, ABC NEWS, REPORT TV, UTV NEWS, SUPERSONIC, STV FOLK, KANALI FOLKLORIT, SCAN TV, IN TV, MUSICAL, CITY TV.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se, njoftimi i marrëveshjes për përjashtim është në përputhje me nenet 5, 48, dhe 49 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Ky njoftim do të nënshtrohet procedurës së përjashtimit të marrëveshjeve nga ndalimi të përcaktuar në Seksionin II të Ligjit “Për Procedurat për përjashtimin e marrëveshjeve nga ndalimi”.

Autoriteti i Konkurrencës fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për marrëveshjen e njoftuar, jo më vonë se 30 ditë, nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 00355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al